



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës që kultivojnë perime në ambient të mbyllur – Serra , se mund të aplikojnë për përkrahje me sistem për ngrohje:

I. Kriteret e përgjithshme:

- 1.Përfituesit duhet të posedojnë Serrën e ngritur në sipërfaqe prej 500m²
- 2.Toka në shfrytëzim duhet të jetë në pronësi të përfituesve. Në rast të fermave familjare pronari i tokës mund të jetë fermeri ose të afërmit e tij/ saj që janë në bashkësi familjare,
3. Përparësi kanë aplikuesit të cilët dëshmojnë se kanë vijuar trajnime relevante/ specifike në lëmin e Perimkulturës,
- 4.Përparësi ka përgatitja profesionale në fushën e bujqësisë (e mesme, superior- e dëshmuar me diplomë përkatëse),
- 5.Vlerësimi i Projekt propozimit të ofruar
- 6.Përparësi kanë fermerët të cilët dëshmojnë se kanë bërë shitjen e produkteve të tyre të kultivuara ne Serra.
- 7.Pjesmarrja e përfituesit duhet të jetë së paku 30% , nga vlera e përkrahjes nga Komuna e Prishtinës,
- 8.Fermeri i cili ofron përqindje më të lartë të participimit do të ketë përparësi.
- 9.Sistemi i ngrohjes në Serrë duhet të jetë ekologjik dhe lënda e cila përdoret për ngrohje të kaldajës duhet të jetë pelleti ekologjik

II. Vlera e përkrahjes për fermer do të jetë deri 4,000.00 Euro - në këtë vlerë është përfshirë edhe participimi i fermerëve

III. Dokumentet e bashkangjitura

Projekt propozimi me përshkrim të hollësishëm:

- a. përshkrimin e gjendjes në fermë;
 - b. qëllimin e investimeve; dhe
 - c. koston e investimeve
-
- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
 - Konfirmimin i llogarisë bankare;
 - Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme me afat deri në një vit;
 - Certifikata e trajnimeve në fushën përkatëse;
 - Diploma për shkollimin përkatës;
 - Certifikata e bashkësisë familjare;
 - Dëshmia-Fatura e shitjes së produkteve.

Data e aplikimit prej 15.05.2018 deri më 04.06.2018